

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Përgjegjës Sektori, Zona II, Drejtoria e Kontrollit të Terrenit, Tirana Veri (Kategoria III-a/1).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar); VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS)*;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe te huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Përgjegjësi i Sektorit ka për detyrë si më poshtë:

Përgjegjësi i Sektorit Zona II, varet nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Terrenit, Tirana Veri.

1. Organizon dhe drejton punën në sektor, programon ngarkesën e punës së sektorit, ndan detyrat për çdo inspektor/specialist/punonjës mbështetës në terren dhe ndjek zbatimin e tyre sipas afateve përkatëse;
2. Mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për realizimin e detyrave të sektorit;
3. Ndjek dhe kontrollon punën për trajtimin efektiv dhe brenda afateve, të praktikave të korrespondencës administrative, të adresuara pranë sektorit;
4. Organizon punën për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim ose dijëni pranë instancave eprore, të planeve të punës, materialeve me karakter informues dhe/ose propozues, informacioneve statistikore;

5. Kontrollon punën e vartësve dhe në rast se vëren mangësi, bën propozimet përkatëse në instancat eprorë për marrjen e masave disiplinore;
6. Në përputhje me programin vjetor të punës, përgatit programet mujore në nivel sektori dhe drejton punën për zbatimin rigoroz të tyre;
7. Harton metodika kontrolli për njohjen dhe zbatimin e ligjit në përputhje me objektin e veprimtarisë së sektorit;
8. Ndjek drejtpërdrejt ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit dhe kontrollit për zbatimin e ligjshmërisë në përputhje me objektin e veprimtarisë së sektorit që mbulon dhe informon eprorin mbi konkluzionet përkatëse;
9. Sipas kualifikimit dhe profilit profesional, mund të kryejë edhe detyra të inspektorit në sektor;

Dokumentat që aplikanti për Përgjegjës Sektori, Zona II, në Drejtorinë e Kontrollit të Terrenit, Tirana Veri, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Dëshmi e gjëndjes mjekësore;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 11.09.2024 **ora** 16.30.